# DËSHMI ARKIVI

**A-475156**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Merr flakë lokali në Athinë ku u vra Pëllumb Islami, zjarrvënie të qëllimshme |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394573.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 06:56:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 28 shtator 2026, 06:51:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 28 shtator 2026, 06:50:00 UTC → 28 shtator 2026, 06:52:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e9f62cb99ac8376e3f86b5d9b33a4a9ef955c410577220f025d653b0dd50d981` |
| TEKSTI | `1d7f31e39afa45f8e2e5e4bad519f2ef57fcc14789fc0678e996ba95310dce16` |
| PAMJA | `3a1d57a34164f8d1240babf4949e746c89cebab672622a36d4179e39ddb61be3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `178509751401030cad4c572fd984f558a7bcd9cbebe10b949fe7257b95160271` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c6e9ce599dcf050571ac11f5fe8a3879623b3af12e442f4fee76de6471dba328` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/178509751401030cad4c572fd984f558a7bcd9cbebe10b949fe7257b95160271`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Merr flakë lokali në Athinë ku u vra Pëllumb Islami, zjarrvënie të qëllimshme

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 28.09.2026, 08:51

Share Share



Një zjarr i përmasave të mëdha shpërtheu herët të hënën në mëngjes në një kafene në rrugën Kastamonis, në Nea Ionia të Greqisë. Flakët nisën në katin përdhes të godinës dhe u përhapën me shpejtësi në tre katet e pallatit, duke detyruar banorët të largoheshin me urgjencë. Një prej banoreve dëshmoi se ishte zgjuar nga zjarri dhe, së bashku me bashkëshortin, kishte dalë në ballkon për të paralajmëruar të tjerët.

Në vendngjarje mbërritën 18 zjarrfikës me pesë automjete, si dhe një automjet special me shkallë. Ekipet e shpëtimit ndërhynë për nxjerrjen e disa personave nga ndërtesa, ndërsa dëshmitarët thanë se disa banorë u detyruan të kalonin përmes flakëve për të dalë jashtë. Sipas informacioneve paraprake, pak para përhapjes së zjarrit është dëgjuar një shpërthim në katin përdhes. Autoritetet po hetojnë mundësinë që shkak të ketë qenë një bombol gazi ose një zjarrvënie e qëllimshme.

Lokali ku shpërtheu zjarri është i njëjti ambient ku, më 22 shkurt 2023, u ekzekutua me armë zjarri 37-vjeçari shqiptar Pëllumb Islami. Deri tani, autoritetet greke nuk kanë konfirmuar ndonjë lidhje mes ngjarjes së sotme dhe vrasjes së tij. Hetimet vijojnë për të përcaktuar shkaqet e zjarrit dhe nëse bëhet fjalë për një incident aksidental apo një akt të qëllimshëm.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.